



Data: 30.06.2023

## **NJOFTIM PËR ZGJATJE TË AFATIT**

Njoftim për zgjatje të afatit për aplikim në shpalljen publike për ekspertë të jashtëm për komisionin e pranimit për pozitën Zëvendës Drejtor Menaxhues –Funksione të Përgjithshme.

Departamenti i Burimeve Njerëzore pranë Agjencisë Kosovare të Privatizimit me datë 21.06.2023 ka bërë shpallje publike për ekspertë të jashtëm për komisionin e pranimit për pozitën Zëvendës Drejtor Menaxhues – Funksione të Përgjithshme. Kjo thirrje ka qenë e hapur deri me datë 28.06.2023.

Meqë numri i aplikacioneve për ekspertë të jashtëm nuk ka qenë i mjaftueshëm për plotësimin e Komisionit të Pranimit, zgjatet afati për aplikim edhe për 7 (shtatë) ditë kalendarike.

Shpallja mbetet e hapur nga data 30/06/2023 deri më 07/07/2023 në ora 16:00.

Për informata shtesë ose sqarime mund të kontaktoni në e-mail adresën: [hr@pak-ks.org](mailto:hr@pak-ks.org)



Data: 21.06.2023

## SHPALLJE PËR APLIKIM

për dy (2) ekspert të jashtëm për anëtarë të Komisionit të Pranimit në Institucionin tjetër shtetëror për pozitën: Zëvendës Drejtor Menaxhues- Funksione të Përgjithshme;

Departamenti i Burimeve Njerëzore në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, në pajtim me dispozitat e nenit 41 paragrafit 5 pika 5.3 të Ligjit për Zyrtar Publik dhe nenit 10 paragrafi 7 të Rregullores (QRK) nr.01/2022 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtues fton të gjitha organizatat e specializuara (ofruesit jo publik të shërbimeve të punësimit, OJQ-të dhe/apo kompanitë e regjistruara në Republikën e Kosovës në fushën e burimeve njerëzore) të dërgojnë ekspertët e tyre për anëtarë të mundshëm të Komisionit të Pranimit në Institucionin tjetër Shtetëror.

Detyrat dhe përgjegjësitë:

Ekspertët e jashtëm do të jetë anëtar të Komisionit të Pranimit në kuadër të Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe duhet t'i plotësojnë kriteret e përcaktuara në nenin 9 paragrafin 5 të Rregullores nr. 01/2022 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtues.

Kriteret e kërkuara:

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

Të kenë diplomë universitare të paktën 240 kredi, kurse për diplomat e marra jashtë vendit, nevojitet nostrifikimi;

Të kenë tetë (8) vite përvojë pune profesionale prej të cilave të paktën pesë (5) vite në pozita të nivelit drejtues;

Të mos kenë qenë anëtarë të organeve drejtuese të ndonjë partie politike të paktën në pesë (5) vitet e fundit;

Të kenë integritet moral dhe profesional;

Të mos kenë aktakuzë të konfirmuar dhe të mos kenë qenë të dënuar për kryerjen e një vepre penale;

Të mos jetë i punësuar në shërbimin civil, të mos jetë i larguar nga shërbimi civil si rrjedhojë e masave disiplinore dhe të mos kenë masa disiplinore në fuqi.

Pagesa:

Anëtari i Komisionit si ekspert i jashtëm në Komisionin e Pranimit, përfiton një pagesë fikse prej dyqind e pesëdhjetë (250.00) Euro për çdo procedurë konkurrimi në të cilën merr pjesë në përputhje me nenin 11 të Rregullores (QRK) nr. 01/2022 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtues.



Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit:

Kandidatët duhet ti dorëzojnë edhe dokumentacionet si më poshtë:

CV-në;

Dëshminë e kualifikimit profesional (diplomën e fakultetit). Për edukimin e marrë jashtë vendit duhet të bashkëngjitet nostrifikimi i diplomës;

Kopjen e letërnjoftimit;

Dëshmi për përvojën e punës;

Dëshmi që nuk ka aktakuzë të konfirmuar dhe nuk është i dënuar për kryerjen e një vepre penale;

Deklaratën se nuk ka qenë anëtarë i organeve drejtuese të ndonjë partie politike të paktën pesë (5) vitet e fundit;

Deklaratën se nuk është i punësuar në shërbimin civil, se nuk është i larguar nga shërbimi civil si rrjedhojë e masave disiplinore dhe të mos ketë masa disiplinore në fuqi.

Organizatave të specializuara mund të aplikojnë përmes postës elektronike dhe dokumentet e kërkuara t'i dorëzojnë në Agjencinë [hr@pak-ks.org](mailto:hr@pak-ks.org)

Për të gjithë të interesuarit ofrohen mundësi të barabarta dhe inkurajojmë organizatat e specializuara që të aplikojnë me kandidatët që i plotësojnë kriteret e shpalljes.

Shpallja mbetet e hapur nga data 21/06/2023 deri më 28/06/2023 në ora 16:00.

Për informata shtesë ose sqarime mund të kontaktoni në e-mail adresën: [hr@pak-ks.org](mailto:hr@pak-ks.org)